



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT
"STRATI" Sh.p.k.




Adresa: Rr. "Jordan Misja", P 141/1, Shk 1, Ap 7, Tiranë, Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com
Cel: Gentian Strati: 0674000450; Valter Kaçupi: 0674000456; Kozeta Guri: 0674000455; Edvin Malotaj: 0674000457

Nr. 2083

Nr. 3079 Prot.

Tiranë më 02.06.2021

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit
Për dijeni : Shoqërisë "Titan Konstruksion" Sh.p.k.
ONE TELECOMMUNICATIONS Sh.A.



Në Tiranë, sot më datë 02.06.2021,

Unë **Kozeta Guri**, përmbaruese gjyqësore private pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, e pajisur me çertifikatë nr. 83, datë Maj 2012, lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, në zbatim të "Urdhërit Ekzekutimit" Nr. 9955 Akti, datë 31.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

KONSTATOVA:

Se në datë 27.02.2013, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe është lidhur kontrata e shërbimit për ekzekutimin e Vendimit për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 9955 Akti, datë 31.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Urdhëri i ekzekutimit është lëshuar për Vendimin Nr. 5525, datë 23.06.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë:

Kreditor : ONE TELECOMMUNICATIONS Sh.A. (ish Telekom Albania Sh.A.)

Debitor : Shoqëria "Titan Konstruksion" Sh.p.k.

Me Objekt : kthim shume

Me Vendimin Nr. 5525, datë 23.06.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

"Pranimin e kërkesë-padisë.

Detyrimin e të paditurit Titan Konstruksion Sh.p.k, t'i paguajë palës paditëse Shoqëria "Albanian Mobile Communications" shumën prej 14,122.00 lekë, si detyrim që rrjedh nga kontrata e abonimit dt.17.01.2001.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve të paditura."

Pasi janë kryer veprimet procedurale rezulton se debitorit i është komunikuar lajmërimi për ekzekutim vullnetar dhe nuk ka ekzekutuar titullin ekzekutiv. Në zbatim të vendimit, është urdhëruar sekuestro konservative mbi aktivet e palës debitore.

Sa më sipër, në kushtet kur pala debitore e ka shlyer tërësisht detyrimin, bazuar në Kodin e Procedurës Civile, Ligjit Nr. 26/2019 datë 08.05.2019 *“Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”*,

URDHËROJ:

1. Heqjen e masën e sekuestros konservative mbi aktivet që pala debitore zotëron të regjistruara pranë jush:
 - Shoqëria **“Titan Konstruktion” Sh.p.k**, me NUIS **J72012004U**, me Administrator **Z. Refki Peposhi**, duke revokuar urdhërin tonë të mëparshëm:
 - Nr. 1495 Prot. datë 05.02.2013;
 - Nr. 8871 Prot. datë 10.07.2013, vetëm për këtë debitor.
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 (pesë) ditëve në Gjykatë.

Përmbaruese Gjyqësore Private


Kozeta Guri

